




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 par 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31. 10. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES SË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtarja e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Linda Shahini nga subjekti politik LDK, e emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në numrin rendor 4 dhe në vend të saj caktohet Majlinda Sylejmani nga i njëjti subjekt politik LDK, i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës për shkak se e lartëcekura ka kaluar në një detyrë të re të punës në kuadër të Shërbimit Civil.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15Nr. 463-67000

Lipjan, më 01. 11. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

